

Rregullorja e maskave për programet verore te WPS

Programet verore të WPS tashme kanë filluar dhe ne duam t'u kujtojmë studenteve, familjeve dhe stafit tonë se Rregullorja e Maskave / e Mbulimit te Fytyrës ne distriktin tone vazhdon te mbetet e pandryshuar per kete periudhe. Kjo përfshin kerkesen që personeli dhe studentët e vaksinuar të vazhdojnë të mbajnë maska / mbulesa fytyre ne kohen qe ndodhen në ndërtesat e shkollës.

Ne jemi në dijeni të udhëzimit të ri të CDC që u botua javën e kaluar, por ai udhëzim është një këshillë federale për shtetet **për fillimin e vitit të ri shkollor në vjeshtë**.

Ne **nuk** kemi marrë ndonjë udhëzim ose rregullore të rishikuar nga departamenti i shtetit ose departamentet lokale të shëndetit publik që do të ndryshonte protokollet tona ekzistuese të shëndetit dhe sigurisë, duke përfshirë protokollet tona ekzistuese të maskave / mbulimit te fytyrës për programet tona që po zhvillohen këtë verë.

Si rezultat, Shkollat Publike të Waterbury **vazhdojnë t'u kërkojnë të gjithë studentëve dhe stafit të mbajnë maskën / te mbulojne fytyren në përputhje me rregulloren e distriktit**.

Nëse udhëzimet ose rregullat e reja në lidhje me mbajtjen e maskave / mbulimit të fytyrës gjatë programeve tona verore lëshohen nga shteti ose departamentet lokale të shëndetit, ne do të rishikojmë dhe do të bëjmë çdo ndryshim të duhur në rregulloren e distriktit. Çdo ndryshim më pas do t'i komunikohet me shkrim stafit tonë, studentëve dhe familjeve.

Si gjithmonë, ju falenderoj për bashkëpunimin dhe ju lutem nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë njoftim mos ngurroni të kontaktoni me administratorin tuaj të programit veror.

.